



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 shtator 2025
Nr. ref.: RK 2760/25

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin KO28/25

Parashtrues i kërkesës

Përparim Rama,
Kryetar i Komunës së Prishtinës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave nr. 01-030/01-227581/23, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa KO28/25 është dorëzuar nga Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës, të cilin me autorizim e përfaqëson Fatos Dibra, Udhëheqës i Zyrës Ligjore në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Rregullorja e kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave nr. 01-030/01-227581/23, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2024 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Rregullores së kontestuar, për të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në përputhje me nenet 10 [Ekonomia], 119 [Parimet e Përgjithshme], 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenet 81 (Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë) dhe 82 (Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (në tekstin e mëtejme: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në nenet 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afati) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 shkurt 2025, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
6. Më 10 shkurt 2025, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KO28/25] caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues, ndërsa përmes Vendimit [nr. KSH. KO28/25] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).
7. Më 11 shkurt 2025, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) Ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, (ii) Ministrin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe (iii) Kryesuesin e Kuvendit të Komunës në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës), të cilëve ju kërkuar që të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, nëse kanë, deri më 27 shkurt 2025. Po ashtu, në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 24 shkurt 2025, Gjykata pranoi komente nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave nr. 01-030/01-227581/23, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2024.
9. Më 27 shkurt 2025, Gjykata pranoi komente nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave nr. 01-030/01-227581/23, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2024.

10. Më 18 mars 2025, Gjykata pranoi parashtrësë nga parashtruesi i kërkesës si përgjigje lidhur me komentet e pranuar në Gjykatë në lidhje me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave nr. 01-030/01-227581/23, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2024.
11. Më 21 maj 2025, Gjykata pranoi *“Kërkesë për ndërhyrje në procedurë, në cilësi të palës së interesuar në rastin nr. KO28/25”* nga Petrit Reçica, Kryeshef i Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A.
12. Më 26 maj 2025, Gjykata aprovoi kërkesën e Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. dhe kërkoi nga të njëjtat paraqitjen e komenteve me shkrim, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e pranimit të njoftimit.
13. Më 13 qershor 2025, Gjykata pranoi komente nga Ndërmarrja “Pastrimi”. Sipas fletëkthesës, rezultoi se Ndërmarrja “Pastrimi” e ka pranuar shkesën e Gjykatës më 29 maj 2025. Megjithatë, për shkak se komentet janë dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar nga Gjykata, të njëjtat nuk u shqyrtuan.
14. Më 15 korrik 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues lidhur me pranueshmërinë e kërkesave dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 13 shtator 2024, Kuvendi i Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi i Komunës) përmes Vendimit [01-060/01-123059/24] shfuqizoi paragrafin 3 të nenit 16 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave nr. 01/030/01-227581/23, të 1 dhjetorit 2023 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave) dhe obligoi Kryetarin e Komunës së Prishtinës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës për zbatimin e vendimit në fjalë.
16. Më 27 shtator 2024, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejshëm: MAPL) përmes Vendimit [nr. 0-947/3] vlerësoi se Vendimi nr. 01-060/01-123059/24 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. MAPL arsyetoi se vendimi i lartcekur ishte në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore (MAPL) nr. 02/2021), për arsye se Kuvendi i Komunës nuk kishte ndryshuar Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave përmes procedurës së njëjtë sikurse të miratimit të saj, por përmes një vendimi.
17. Më 5 dhjetor 2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme miratoi Rregulloren e kontestuar me 27 (njëzet e shtatë) vota për, 0 (zero) kundër dhe 1 (një) abstenim.
18. Në të njëjtën ditë, Kuvendi i Komunës përmes Vendimit [01-101/03-161697/24] shfuqizoi Vendimin [nr. 01-060/01-123059/24] të 18 shtatorit 2024 lidhur me shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.
19. Më 6 dhjetor 2024, Kuvendi i Komunës i dërgoi MAPL-së listën e akteve të miratuara në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës të mbajtur më 5 dhjetor 2024, si në vijim: (i) Vendimin për shfuqizimin e vendimit [nr. 01-060/01-123059/24], të 18 shtatorit 2024 dhe (ii) Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave [nr. 01-030/01-227581/23] të 1 dhjetorit 2023.

20. Më 9 dhjetor 2024, MAPL përmes Vendimit [nr. 0-947/11] i dërgoi Rregulloren e kontestuar Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejme: MMPHI) për shqyrtimin e ligjshmërisë si institucion përgjegjës, bazuar në nenin 3 të Rregullores (QRK) nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.
21. Më 13 dhjetor 2024, Sektori Ligjor i Komunës së Prishtinës iu drejtua MAPL përmes komunikimit elektronik, me njoftimin lidhur me mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të mbajtur më 5 dhjetor 2024, me rendin e ditës: (i) Anulimin e Vendimit për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave të 18 shtatorit 2024; dhe (ii) Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave. Përmes këtij komunikimi, Sektori Ligjor i Komunës së Prishtinës njoftoi MAPL që konsideron se procesi i hartimit të aktit nënligjor të miratuar në seancën e 5 dhjetorit 2024 ishte bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë procesin e hartimit dhe mbajtjes së konsultimit publik të akteve nënligjore të Komunës.
22. Më 20 dhjetor 2024, MMPHI, përmes shkresës [nr. V - 197/24] i dorëzoi Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores së kontestuar, me të cilën konfirmoi ligjshmërinë e të njëjtës, me arsyetimin se Rregullorja e kontestuar është në përputhshmëri me Ligjin nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Ligjin 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina.
23. Më 23 dhjetor 2024, MAPL iu drejtua Sektorit Ligjor të Komunës së Prishtinës përmes përgjigjes në kërkesë [0-947/15] sqaroi se në përputhje me mandatin e përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe shtojcën I, pikës 9 të Rregullores (QRK) – nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive: *“Aktet e komunës të cilat miratohen për fusha për mbikëqyrjen e të cilave nuk është kompetente MAPL, përgjegjëse janë ministrinë e linjës, institucionet dhe agjencitë tjera qendrore të cilat shërbejnë si organe mbikëqyrëse siç përcaktohet me nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave; Rregulloren Nr. 01-030/01-0161704/24 të datës 25.11.2024, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave Nr.01-030/01-227581/23 të datës 01.12.2023 e miratuar nga kuvendi i komunës së Prishtinës, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka vlerësuar se është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Rregullorja e kontestuar nuk është në përputhje me nenet 10 [Ekonomia], 119 [Parimet e Përgjithshme], 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe 124 [Organizimi dhe Funksimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës dhe nenet 81 (Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë) dhe 82 (Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, për shkak se të njëjtës nuk i është bërë shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë së aktit administrativ nga ana e MAPL-së.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se iniciimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së kontestuar nuk është bërë nga organet e autorizuar sipas Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komunë (në tekstin e mëtejme: Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 04/2023).
26. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se miratimi i Rregullores së kontestuar ka rezultuar në shkelje të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023, për shkak se

procedura e konsultimit nuk është zhvilluar nga drejtoria në kuadër të fushë-veprimtarisë që rregullon projekt-akti i caktuar dhe në mungesë të hapave të përcaktuar në nenin 14 (Transparenca në aktivitetet e prokurimit) të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023.

27. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se Rregullorja e kontestuar është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 81 (Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, për shkak se MAPL ka deleguar kompetencën për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores së kontestuar në MMPHI. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Ky delegim i kompetencës është kontradiktor me arsyet dhe faktet vendimtare të theksuara në Vendimin nr.0-947/6 datës 07.10.2024, ku fillimisht MAPL konsideron se ka legjitimet aktiv kur ka vlerësuar se akti është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ndërsa pas Kërkesës të marrë nga Zyra Ligjore e Kryeqytetit, lëndën kanë deleguar tek MMPHI, ku ndër të tjera theksojnë citoj: Aktet e komunës të cilat miratohen për fusha për mbikëqyrjen e të cilave nuk është kompetent MAPL, përgjegjëse janë ministrisë së linjës, institucionet dhe agjencitë tjera qendrore të cilat shërbejnë si organe mbikëqyrëse siç përcaktohet me nen 7 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrative të akteve të Komunës.”*
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se MMPHI nuk e ka shqyrtuar Rregulloren e kontestuar në aspektin procedural, por vetëm në mënyrë sipërfaqësore ka konfirmuar të njëjtën se është në harmoni me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturinat dhe Ligjit nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturinat.
29. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës kërkon që (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të Kushtetutës me rastin e nxjerrjes së Rregullores së kontestuar, për arsye se nuk i është bërë shqyrtimi i detyrueshëm nga MAPL; dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm Rregulloren e kontestuar.

Prendimet e parashtruesit të kërkesës të dorëzuar përmes parashtrësës së 18 marsit 2025

30. Parashtruesi i kërkesës, përmes parashtrësës së dorëzuar në Gjykatë, specifikon pretendimet e tij duke shtuar se Rregullorja e kontestuar është në kundërshtim me nenin 10 [Ekonomia], paragrafin 3 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme], 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës, për arsye se përmes paragrafit 3 të nenit 5 të Rregullores së kontestuar është fshirë paragrafi 3 i nenit 16 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, i cili përcakton se: *“Komuna e Prishtinës mund të angazhojë kompani tjetër për ti ndihmuar Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “Pastrimi” në rast të vështirësive gjatë operimit”*.
31. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se janë cenuar rëndë parimet e ekonomisë së lirë të tregut dhe konkurrencës, për shkak se: *“[...] me miratimin e Rregullores e cila është objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë sipas kërkesës KO28/25, është krijuar monopol ashtu që për ofrimin e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave, i është lënë e drejta vetëm KRM “Pastrimi” Sh.a veprim i cili është i ndaluar, respektivisht nuk është i lejuar në mënyrë eksplicite me ligj.”*
32. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se dispozitat e Rregullores së kontestuar, konkretisht paragrafi 2a dhe 2b i nenit 14 i saj, paraqesin ndërhyrje direkte në kompetencat vetanake dhe ekskluzive të Komunës, me arsyetimin se faturimi i pagesës së taksës për mbledhjen e mbeturinave nuk mund të bëhet nga një kompani, e cila është e kontraktuar dhe paguhet për shërbimin e mbledhjes dhe menaxhimit të tyre.

33. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon se Rregullorja e kontestuar është “në kundërshtim me kapitullin X “Qeverisja lokale dhe organizimi territorial” respektivisht nenin 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 17, pika f) e Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale”.

Komentet e dorëzuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më 24 shkurt 2025

34. Më 24 shkurt 2025, Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së dorëzoi në Gjykatë komentet ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me Rregulloren e kontestuar.
35. Fillimisht, Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së sqaron se Rregulloren e kontestuar e ka pranuar nga MAPL bazuar në nenin 9 të Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (në tekstin e mëtejme: Rregullore (QRK) nr. 10/2019) përmes shkresës përcjellëse. Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së sqaroi se Rregullorja e kontestuar i është nënshtruar shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e MMPHI-së në fushën profesionale në përputhje me pikën 4.3 të nenit 7 të Rregullores (QRK) nr. 10/2019.
36. Në këtë drejtim, Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së thekson se MMPHI më 20 dhjetor 2024 kishte dhënë përgjigjen në vlerësimin e ligjshmërisë sipas shkresës përcjellëse me [nr. prot. 8095-2/25] ku konfirmoi Rregulloren në fjalë.
37. Më tutje, Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së konsideron se: “[...] MMPHI ka dhënë vlerësimin e ligjshmërisë në aspektin profesional, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe procedurave të parapara në Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave”. Më tutje, e njëjta njoftoi se MMPHI nuk ka kompetencë të bëjë shqyrtimin procedural të akteve komunale.

Komentet e dorëzuara nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Prishtinës, më 27 shkurt 2025

38. Më 27 shkurt 2025, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dorëzoi në Gjykatë komente përkitazi me Rregulloren e kontestuar.
39. Fillimisht, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Prishtinë konsideron se kërkesa e parashtruar nga Kryetari i Komunës nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, konkretisht për të qenë palë në procedurë pranë Gjykatës, për shkak se akti i kontestuar në kuptim të paragrafit 4 të nenit 113 nuk është akti i Qeverisë, por është akt i Komunës së Prishtinës, respektivisht Kuvendit të Komunës.
40. Në këtë drejtim, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thekson se: “[...] kërkesa e parashtruesit – Kryetarit të Komunës nuk përbën bazë për t’iu nënshtruar kontrollit kushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese, sepse e njëjta në kuptim të nenit 113, par. 4 të Kushtetutës nuk përbën akt të Qeverisë, me të cilin do të supozohej cenimi i autoritetit kushtetues të komunave, i cili si i tillë, do të përbente bazë për t’u legjitimuar si palë e autorizuar për ngritjen e një rasti pranë kësaj gjykate.”

41. Gjithashtu, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës lidhur me kriteret e pranueshmërisë së kërkesave mbi bazën e paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, konkretisht rastit [KO145/21](#), parashtrues *Komuna e Kamenicës*, Aktgjykim i 23 prillit 2021; dhe [KO139/18](#), parashtrues *Komuna e Skenderajt*, Aktvendim i 30 shtatorit 2020, paragrafi 39).
42. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thekson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 40 dhe 41 të Ligjit dhe për këto arsye e njëjta nuk do të duhej të shqyrtohej nga ana e Gjykatës. Për këto arsye, Kuvendi Komunal konsideron se nuk është e nevojshme të komentojë përmbajtjen e kërkesës së parashtruesit të kërkesës, për shkak se është i bindur që kërkesa do të shpallet e papranueshme dhe si e tillë nuk do t'i nënshtrohet kontrollit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës.

Komentet e dorëzuara nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal më 27 shkurt 2025

43. Më 27 shkurt 2025, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së dorëzoi në Gjykatë komente për Rregulloren e kontestuar.
44. Fillimisht, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së sqaron në mënyrë kronologjike miratimin e aktit të kontestuar, duke theksuar se në rastin e parë kur Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave ishte ndryshuar përmes një vendimi, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së kishte vlerësuar se akti ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Më tutje, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së sqaron se në këtë rast shkëlja ka qenë procedurale dhe këtë vlerësim është dashur ta jep MAPL, si ministri me mandat mbikëqyrës në këtë rast. Më pas, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së në kontekst të procedurës së zhvilluar sqaron që pas shfuqizimit të vendimit, Kuvendi Komunal miratoi Rregulloren e kontestuar. Gjithashtu, i njëjti sqaron se Rregullorja e kontestuar është shqyrtuar nga MMPHI bazuar në paragrafin 1 të nenit 7 të Rregullores (QRK) nr. 10/2019 dhe sipas këtij vlerësimi Rregullorja e kontestuar është në përputhje me legjislacionin në fuqi.
45. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i MAPL konsideron se në procesin e shqyrtimit të akteve të Kuvendit Komunal kishte vepruar në përputhje me mandatin ligjor, duke vënë theksin në: *“a. Në rastin e parë kur Kuvendi i Komunës ka nxjerrë vendim për Ndryshimin e Rregullores, MAPL, ka bërë vlerësimin e aktit (vendim) në aspektin procedural, duke vlerësuar se akti është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi; b. Në rastin e dytë kur Kuvendi i Komunës ka nxjerr Rregullore për Ndryshim Plotësimin e Rregullores si akt, MAPL, e ka dërguar aktin (rregullore) për shqyrtim në ministrinë e linjës, sipas mandatit për shqyrtimin e aktit nga fushë veprimtaria e ministrisë së linjës, duke vlerësuar aktin në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

Komentet e dorëzuara nga Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. më 13 qershor 2025

46. Më 13 qershor 2025, Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A, dorëzoi në Gjykatë komente për Rregulloren e kontestuar.
47. Fillimisht, Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. thekson se mbështet në tërësi komentet e parashtruara nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, për shkak se Rregullorja e kontestuar nuk i përmbush asnjë nga kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 113 të Kushtetutës.

48. Më tutje, Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. thekson se: “[...] në bazë të nenit 10, par.4 të ligjit në fuqi për Konfliktet Administrative, është Gjykata Supreme e Kosovës e cila, përveç të drejtës ligjore për të gjykuar Revizionin, ka kompetencë ekskluzive për të gjykuar edhe padinë për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ (si në rastin konkret – Rregulloren e kontestuar) dhe këtë mund ta bëjë si shkallë e parë dhe e vetme në nivel të sistemit gjyqësor të Kosovës”. Në këtë drejtim, i njëjti i sjell në vëmendje Gjykatës se parashtruesi i kërkesës, ka iniciuar edhe padi për shfuqizimin e pjeshëm të Rregullores së kontestuar në Gjykatën Supreme të Kosovës, ku njëkohësisht ka parashtruar kërkesë për caktimin e masës së përkohshme, të cilën Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [P.A.nr.05/2025] të 29 majit 2025, refuzoi si të pathemeltë kërkesëpadinë dhe kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të parashtruesit të kërkesës.
49. Gjithashtu, Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës “nuk i përmbush asnjërin nga kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim in meritum nga ana e kësaj gjykate, ngase parashtruesi i saj ka dështuar që të argumentojë se pse akti i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën, e për më tepër as nuk ka referuar ndonjë dispozitë konkrete relevante kushtetuese, te cilën parashtruesi i kërkesës e konsideron se akti i kontestuar e ka cenuar.”
50. Në fund, Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. kërkon që kërkesa e parashtruesit të kërkesës “të shqyrtohet me urgjencë në mënyrë që të hapet rruga për rimbursimin e mjeteve financiare të cilat tash e disa muaj janë bllokuar nga ky i fundit, ku për pasojë, është bllokuar ofrimi i shërbimit themelor të ndërmarrjes – grumbullimi i mbeturinave, të cilat po rrezikojnë çdo ditë edhe jetën e qytetarëve krahas degradimit të ambientit publik”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 10 [Ekonomia]

“Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.”

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

[...]

Neni 119 [Parimet e Përgjithshme]

[...]

3. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.”

[...]

Neni 123 **[Parimet e Përgjithshme]**

- “1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.
2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.
4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.”

Neni 124 **[Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]**

- “1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
3. Komunitetet kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
4. Komunitetet kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.
5. Komunitetet kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.
6. Komunitetet obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.
7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.”

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE, NR. 01-030/01-227581/23 (Rregullorja e kontestuar)

Neni 1 **Qëllimi**

“Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr.01-030/01-227581/23 për menaxhimin e mbeturinave dhe ndërgjegjësimi i publikut drejt riciklimit të mbeturinave.”

Neni 2

- “1. Pas paragrafit 2 të nenit 7, shtohet paragrafi i ri 3 me tekstin në vijim:
3. Operatori publik i kontraktuar nga Komuna e Prishtinës sipas nenit 16 paragrafi 2 të rregullores bazë, është e obliguar të regjistroj dhe mbajë regjistër të

klientëve të amvisërisë dhe bizneseve dhe njofton Komunën sipas kërkesës së saj lidhur me përditësimin e regjistrit të klientëve.”

Neni 3

“1. Paragrafi 1 i nenit 12, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

- 1. Kjo leje zëvendëson licencën për menaxhimin e mbeturinave që më parë është lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kjo leje lëshohet nga Komuna e Prishtinës dhe ulen për operim vetëm në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe ka afat të vlefshmërisë për një periudhë tre (3) vjeçare siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi për lejet mjedisore. Leja mund të vazhdohet pas parashtrimit të kërkesës nga kompania përkatëse në Sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe energjisë eficiente.”*

Neni 4

“1. Paragrafi 2 i nenit 14 të Rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

Faturimi i taksës së mbeturinave për amvisëri apo njësi banimi bëhet në baza mujore nga kompania "Pastrimi" SH.A, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave përmes inkasantëve të Kompanisë Regjionale "Pastrimi" SH.A. më së largu deri në ditën e dhjetë (10) të muajit pasues dhe pagesa nga gjeneruesi i bëhet direkt kompanisë Pastrimi Sh. A. përveç kategorive të liruara me ligj për të cilat do të kryhet pagesa nga Komuna e Prishtinës Ndërmarrjes publike Pastrimi.

- 2. Pas paragrafit 2 të nenit 14 të Rregullores bazë shtohet paragrafi i ri 2a. dhe 2b. me tekstin si në vijim:
2a. Kompania Pastrimi Sh.A faturon bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha si dhe institucione ne Komunën e Prishtinës për të cilat ka kontratë të veçantë dhe ju ofron shërbim.
2b. Pagesa nga bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha si dhe institucione në Komunën e Prishtinës për kryerjen e shërbimit sipas paragrafit 2a. i paguhet direkt kompanisë Pastrimi Sh.A.”*

Neni 5

“1. Paragrafi 1 i nenit 16 të rregullores bazë plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

- 1. Operatori publik i kontraktuar nga organi kontraktues për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.*
- 2. Paragrafi 2 i nenit 16 të rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:
2. Operatori publik i kontraktuar nga Komuna e Prishtinës për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave është kompania publike "Kompania Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi" SH.A. Kompania Regjionale "Pastrimi" SH.A. është e obliguar të veprojë sipas kontratave të cilat mund të arrihen me Komunën e Prishtinës duke respektuar legjislacionin në fuqi .*
- 3. Paragrafi 3 i nenit 16 fshihet.”*

Neni 6

“1. Pas paragrafit 5 të nenit 18, shtohet paragrafë te ri 6 dhe 7 me tekstin si në vijim:

- 6. Kompania regjionale Pastrimi Sh. A raporton inspektionit të Komunës në rast të identifikimit të personave juridik për hedhje të mbeturinave të rrezikshme dhe të gjitha mbeturinave të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni. Raportimi mund të bëhet përmes shkresës, fotografisë, video incizimit ose gfarëdo forme tjetër përmes se cilës identifikohet kryesi i shkeljes.*
- 7. Të hyrat nga gjobitja sipas paragrafit 6 të këtij neni, Komuna mund ti bartë Kompanisë Pastrimi .”*

Neni 7 Hyrja në fuqi

“Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.”

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pranueshmërinë e komenteve të Kryeshefit të Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A.

51. Gjykata së pari vëren se, më 21 maj 2025, Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. kishte dorëzuar kërkesë për ndërhyrje në procedurë në cilësi të palës së interesuar. Gjykata, më 26 maj 2025, aprovoi kërkesën e Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. dhe kërkoj nga të njëjtit paraqitjen e komenteve me shkrim, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e pranimit të njoftimit.
52. Më pas, më 13 qershor 2025, Gjykata pranoi komente nga Ndërmarrja “Pastrimi”. Sipas fletëkthesës, rezulton se Ndërmarrja “Pastrimi” e ka pranuar shkesën e Gjykatës më 29 maj 2025.
53. Në vijim, në kuadër të shqyrtimit të plotësimit komenteve të Kryeshefit të Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A., të dorëzuar në datën e lartcekur, Gjykata fillimisht i referohet dispozitave përkatëse të Ligjit për Gjykatën dhe Rregulloren e saj të punës.
54. Gjykata i referohet paragrafit 4 të rregullit 26 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit të përgjigjeve) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(4) Përveç nëse kërkohet nga Gjykata ose nëse merret leje me shkrim nga Gjykata, pala parashtruese nuk mund të dorëzojë asnjë dokument pas afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës. Gjykata mund të urdhërojë një afat më të shkurtër kur një kërkesë i nevojitet trajtim i përshpejtuar”.
55. Gjykata rikujton se, përmes shkresës së 26 majit 2025 e njoftoi Kryeshefin e Ndërmarrjes “Pastrimi” Sh.A. që mund t’i paraqesin komentet brenda 7 (shtatë) ditëve nga pranimi i shkresës. Në këtë aspekt, Gjykata marrë për bazë faktin, që ka caktuar afat prej 7 (shtatë) ditësh nga data e pranimit të njoftimit dhe që Kryeshefi i Ndërmarrjes “Pastrimi” e ka pranuar njoftimin e Gjykatës më 29 maj 2025 konstaton se komentet e Ndërmarrjes “Pastrimi” të dorëzuara më 13 qershor 2025 janë paraqitur jashtë afateve procedurale të përcaktuara me Ligj dhe rregullin 26 të Rregullores së punës (shih, rastet e Gjykatës [KI100/23](#), me parashtrues *Miradije Tusha, Naser Tusha, Artan Tusha, Ajshe Tusha, Hatixhe Tusha, Nadire Tusha dhe Nurhane Vladi-Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 shkurtit 2024, paragrafët 56-57 dhe [KI171/23](#), parashtrues *Latif Zariqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 prillit 2024, paragrafët 35-43).
56. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se afatet e përcaktuara me Rregulloren e punës, në kuptim të procedurës së shqyrtimit të kërkesës para Gjykatës, i shërbejnë sigurisë juridike, që nënkupton që palët në procedurë para Gjykatës janë paraprakisht të njoftuara në lidhje me (i) kushtet e dorëzimit të një kërkesë në Gjykatë, (ii) të drejtës së palës kundërshtare për të paraqitur përgjigje dhe (iii) afatit të dorëzimit të informatave dhe parashtrësive tjera brenda afateve të përcaktuara me Ligj dhe Rregullore të punës (shih rastin [KI100/23](#), cituar më lart, paragrafi 58 dhe [KI171/23](#), cituar më lart, paragrafi 42).
57. Rrjedhimisht, Gjykata do të vazhdojë me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës dhe shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

58. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruar para Gjykatës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
59. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*
60. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka ngritur kërkesën e tij në bazë të paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.”

61. Gjithashtu, Gjykata i referohet neneve 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afatet) të Ligjit, e të cilët përcaktojnë:

Neni 40
(Saktësimi i kërkesës)

“Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës, komuna paraqet, ndër të tjera, informatat përkatëse në lidhje me ligjin apo aktin e kontestuar të Qeverisë, cila dispozitë e Kushtetutës supozohet se është shkelur dhe cilat përgjegjësi apo të hyra komunale janë prekur nga një ligj apo akt i tillë.”

Neni 41
(Afatet)

“Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës.”

62. Ndërsa, Gjykata i referohet edhe rregullit 71 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 40 dhe 41 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili specifikon:

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (4) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 40 (Saktësimi i kërkesës) dhe 41 (Afatet) të Ligjit.

(2) Në kërkesën e parashtruar sipas këtij rregulli, komuna, ndër të tjera, duhet të paraqesë informatat e mëposhtme:

(a) informatat përkatëse në lidhje me ligjin apo me aktin e kontestuar të Qeverisë;

(b) dispozitën e Kushtetutës e cila supozohet se është shkelur; dhe

(c) përgjegjësitë komunale ose të hyrat e komunës të zvogëluara, rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

(3) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të parashtrohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës së ligjit ose të aktit të kontestuar të Qeverisë.

63. Andaj, bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, në mënyrë kumulative duhet t'i plotësojë kushtet si në

vijim: (i) Komuna duhet të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji të Kuvendit ose të një akti të Qeverisë; dhe (ii) Komuna duhet të argumentojë se ligji ose akti i kontestuar cenon përgjegjësitë komunale ose zvogëlon të hyrat e saj. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se këto kushte janë kumulative, përkatësisht Komuna përkatëse duhet të kontestojë ligjin e Kuvendit ose aktin e Qeverisë dhe të argumentojë se të njëjtat kanë cenuar ose zvogëluar përgjegjësitë komunale ose të hyrat e saj (shih, rastin e Gjykatës [KO139/18](#), parashtrues *Komuna e Skenderajt*, Aktvendim për papranueshmëri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, Nr. 05-3815, të 12 qershorit 2018, i 30 shtatorit 2020, paragrafi 39; rastet [KO159/21](#) dhe [KO160/21](#), parashtrues *Komuna e Prishtinës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit Komunal nr. 020-558/17 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të 12 korrikut 2021” në lidhje me “konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prishtinës nr. 5133 të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të 9 korrikut 2021”, Aktgjykim i 3 korrikut 2023, paragrafi 51). Gjithashtu, bazuar në Ligj dhe në Rregulloren e punës, ky ligj ose akt i Qeverisë duhet të kontestohet në Gjykatë brenda 1 (një) viti nga hyrja e tij në fuqi.

64. Për këto arsye, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse para saj kontestohet një ligj i Kuvendit ose një akt i Qeverisë dhe pastaj, në rast se përgjigja është afirmative, atëherë duhet të vlerësojë nëse ligji/akti përkatës zvogëlon përgjegjësitë komunale ose cenon të hyrat e saj.
65. Në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës, ashtu siç është specifikuar më lart, parashtruesi i kërkesës konteston Rregulloren e miratuar nga Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2024, për të cilën shqyrtimi i ligjshmërisë ishte bërë nga MMPHI, pas përcjelljes së të njëjtës nga MAPL, bazuar në nenin 3 të Rregullores (QRK) nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave. Gjykata vëren se Rregullorja e kontestuar bazohet në pikën c të paragrafit 2, të nenit 12, pikën f, të nenit 17, dhe pikën a, të paragrafit 2 të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neneve 15 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071, pikën a të nenit 8, pikën f të nenit 15 dhe paragrafit 1 të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe pikën f të nenit 15, dhe nenit 33 të Statutit 01 Nr. 110-391 të Komunës së Prishtinës, të 25 shkurtit 2010. Rregullorja e kontestuar është nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Fehmi Kupina.
66. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore kishte trajtuar raste të cilat kërkonin vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të ndryshme të Qeverisë. Në këto raste, Gjykata kishte vlerësuar nëse një akt i tillë mund të hyjë në kategorinë e akteve të përcaktuara nga juridiksioni i Gjykatës sipas nenit 113 të Kushtetutës (shih, rastet [KO73/16](#), parashtrues *Avokati i Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016 të 21 janarit 2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike, Aktgjykim i 16 dhjetorit 2016, paragrafët 46, 56 dhe 58; [KO61/20](#), parashtrues *Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; dhe Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020], [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut, Aktgjykim i 5 majit 2020, paragrafët 92 deri 98 dhe referencat e tjera të përdorura aty). Përderisa, në kontekst të juridiksionit të përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata kishte konstatuar që aktet nënligjore të nxjerra nga ministritë dhe vendimet e ministrave hyn në fushëveprimin e “akteve të qeverisë” (shih, rastet [KO145/21](#), parashtrues *Komuna e Kamenicës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/24,

- të 23 prillit 2021, Aktgjykim i 10 marsit 2022; [KO173/21](#), parashtrues *Komuna e Kamenicës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 3, 4, 5, 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) nr. 104/2020 për “Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar”, të nxjerra nga Ministria e Arsimit).
67. Për më tepër, Gjykata thekson se në rastet [KO159/21 dhe KO160/21](#), kishte shqyrtuar kërkesat e Komunës së Prishtinës lidhur me kontestimin e akteve “Raport i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit Komunal [nr. 020-558/17] të 12 korrikut 2021”, të MAPL-së, përkatësisht “Raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit Komunal [nr.020-558/10] të 8 korrikut 2021”, të MAPL-së, të cilat i vlerësoi si të pranueshme me arsyetimin se hynë në kategorinë e “akteve të Qeverisë”. Në këtë drejtim, në rastet e lartcekura, Gjykata vlerësoi se aktet e kontestuar prodhojnë efekte dhe pasoja për parashtruesin e kërkesës duke i pamundësuar vazhdimin procedural dhe se në këto rrethana konsideroi se aktet e kontestuar janë “akt i qeverisë”, në pajtim me nenin 113 paragrafi 4 i Kushtetutës dhe nenin 40 të Ligjit.
 68. Për dallim nga rastet e sipërcekura, në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës kontestohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, nr. 01-030/01-227581/23, e miratuar nga Kuvendi Komunal. Në kontekst të paragrafit 4 të nenit 113 të Kushtetutës, kjo Rregullore nuk përbën as “ligj” të Kuvendit të Kosovës dhe as “akt të Qeverisë”, por është një akt nënligjor i miratuar nga Kuvendi i Komunës. Prandaj, duke marrë për bazë atë që akti i kontestuar nuk përmbush kriterin e parë të pranueshmërisë, pasi nuk është as ligj as akt i miratuar nga “Qeveria”, Gjykata nuk do të vazhdojë me vlerësimin e asaj nëse Rregullorja e kontestuar e miratuar nga Kuvendi Komunal mund të ketë cenuar përgjegjësitë komunale ose zvogëluar të hyrat e saj, siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës. Thënë këtë, Gjykata rikujton që Rregullorja e kontestuar ishte objekt i vlerësimit të përputhshmërisë së saj me Ligjin për Mbeturinën nga MMPHI, megjithatë, parashtruesi i kërkesës, përkundër asaj që, ndër të tjera, konteston edhe procedurën e miratimit të Rregullores së kontestuar, në kërkesën e tij ka specifikuar se konteston Rregulloren e kontestuar, si akt nënligjor i miratuar nga Kuvendi Komunal, duke kërkuar edhe shpalljen e pavlefshme të saj.
 69. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vë në dukje praktikën e saj gjyqësore në rastet paraprake të shqyrtuara nga ajo e të dorëzuara në Gjykatë bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilat i kishte shpallur si të papranueshme për shkak se aktet e kontestuar nuk ishin “akte të Qeverisë” (shih, rastet [KO08/13](#), parashtrues *Komuna e Klinës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007, dhe pesëmbëdhjetë (15) vendime të tjera, dhe kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme, Aktvendim për papranueshmëri, i 14 nëntorit 2013; [KIO7/10](#), parashtrues *Komuna e Klinës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2010; [KO139/18](#), parashtrues *Komuna e Skenderajt*, Aktvendim për papranueshmëri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, Nr. 05-3815, të 12 qershorit 2018, cituar më lart, dhe [KO123/10](#), *Komuna e Gjakovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë [C. nr. 183/2009] të 17 qershorit 2009, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 majit 2011).
 70. Në vijim, dhe në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Rregullores së kontestuar, bazuar në juridiksionin e Gjykatës bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje se ndaj Rregullores së kontestuar, si akt normativ administrativ i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës (i) parashtruesi i kërkesës mund të paraqes padi, bazuar në nenin 13 (Llojet e padive) të Ligjit nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative; dhe (ii) bazuar në paragrafin 4 të nenit 10 (Organizimi dhe

Kompetenca) të Ligjit nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, Gjykata Supreme është kompetente për gjykimin në shkallë të parë lidhur me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor.

71. Rrjedhimisht dhe në përfundim, bazuar në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 40 të Ligjit dhe paragrafin 1 të rregullit 71 të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës, duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 4 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20, 40 dhe 41 të Ligjit, dhe rregullat 48 (1) (b) dhe 71 (1) të Rregullores së punës, më 15 korrik 2025, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Enver Peci

Nexhmi Rexhepi